



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 25.10.2023

Nr: 183

Ora: 13:00

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 32, DATË 25.10.2023 TË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 25.10.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Tonin Marinaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për bashkinë Malësi e Madhe dhe ndaj z. Kastriot Dragaj, Drejtor i shkollës 9-vjeçare “Fran Murriz”, në Pjetroschan, Malësi e Madhe

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 25.10.2023 Nr: 183
Ora: 13:00



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 32, datë 19.10.2023”

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 32 regj., datë 19.10.2023. Në mbledhjen e datës 25.10.2023, ora 13:00, pas relatimit të z. Koli Bele, u konstatua se kërkesa i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 32, datë 19.10.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 26.10.2023, ora 13:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar